

VENDIM
Nr.849, datë 5.8.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN E
STATUSIT TË ZHVILLUESIT TË ZONËS EKONOMIKE, ME STATUSIN E ZONËS SË
LIRË, TË NJË TERRITORI NË VLORË, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, dhe të neneve 4, pika 1, shkronja “g”, 5, pikat 1 e 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, me statusin e zonës së lirë, të një territori në Vlorë, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 8 për qind të pikëve për rezultatin ekonomik, financiar, teknik dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse, konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Zumax AG”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha